

VENDIM
Nr. 297, datë 28.5.2025

**PËR AUTORIZIMIN E KORPORATËS SË INVESTIMEVE SHQIPTARE PËR
KOORDINIMIN E PROCESIT TË IDENTIFIKIMIT TË PRONËS SHTETËRORE
ME INTERES PËR TË REALIZUAR PROJEKTE INVESTIMI NË ZONËN
INDUSTRIALE TË ISH-KOMBINATIT METALURGJIK, BASHKIA ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 5, të ligjit nr. 71/2019, “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Korporata e Investimeve Shqiptare, në përputhje me objektivat e saj, me qëllim identifikimin e pronës shtetërore me interes për të realizuar projekte investimi në zonën industriale të ish-Kombinatit Metalurgjik, Bashkia Elbasan, ngarkohet për përmbushjen e detyrave, si më poshtë vijon:

a) Të ndër marrë të gjitha masat dhe veprimet procedurale për konsolidimin e pronës shtetërore në këtë zonë, si më poshtë vijon:

i. Në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës koordinimin dhe bashkërendimin me institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, të përfshira në çështjet e pronësisë apo administrimit të këtyre pronave, për dhënien dhe shkëmbimin e informacionit apo të dokumentacionit të kërkuar, në lidhje me të drejtat e pronësisë, që është i nevojshëm për një pasqyrim të gjendjes së pronësisë, caktimin më të saktë të kufijve të zonës dhe përfundimin me prioritet të procesit të regjistrimit të pronës në regjistrat e pasurive të paluajtshme;

ii. Në bashkëpunim me shoqëritë shtetërore në përdorim të të cilave janë pasuritë brenda zonës së parkut metalurgjik, përcaktimin e statusit ligjor në librat e tyre kontabël;

iii. Negociimin me subjektet private, të përfshira në marrëdhënien juridike të pronësisë për këto prona, në lidhje me sqarimin dhe qartësimin e statusit të pjesës përkatëse të pronës shtetërore në këtë zonë;

b) Të hartojë dhe të sigurojë, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe Agjencinë e Zhvillimit të Territorit një plan të detajuar qendror të zhvillimit të zonës, në të cilin ndodhet prona shtetërore. Shpenzimet për realizimin e këtij plani të detajuar qendror mbulohen nga buxheti i Korporatës së Investimeve Shqiptare;

c) Të hartojë dhe të paraqesë, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, një projekt zhvillimi të pronës shtetërore në këtë zonë. Shpenzimet për realizimin e këtij projektzhvillimi mbulohen nga buxheti i Korporatës së Investimeve Shqiptare dhe/ose partnerët privatë.

2. Institucionet shtetërore të përfshira në çështjet e pronësisë apo administrimit të pronave, sipas parashikimit të nënndarjeve “i” dhe “ii”, të shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij vendimi, të paraqesin informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar, brenda 5 (pesë) ditëve nga momenti i administrimit të kërkesës së paraqitur me shkrim nga Korporata e Investimeve Shqiptare.

3. Korporata e Investimeve Shqiptare i paraqet raport të detajuar, lidhur me përmbushjen e detyrave të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, ministrisë përgjegjëse për ekonominë, e cila, pas konfirmimit të përmbushjes së detyrave, merr në shqyrtim kërkesën e Korporatës së Investimeve Shqiptare, në zbatim të pikës 1, të kreut II, të vendimit nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfitëozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Korporata e Investimeve Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku